



Metoda Kërkimi

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Kapitulli 4

Filozofitë dhe Metodat e Kërkimit



Objektivat

- Të përkufizoni termat epistemologji, ontologji dhe aksiologji dhe të shpjegoni lidhjen e tyre me kërkimin
- Të shpjegoni lidhjen që kanë me kërkimin shkencor perspektivat filozofike si pozitivizmi, realizmi, pragmatizmi, interpretivizmi, objektivizmi dhe subjektivizmi.
- Të dalloni midis dy metodave (qasjeve) kryesore të kërkimit: deduktive dhe induktive
- Të përcaktoni pozicionin tuaj epistemologjik, ontologjik apo aksiologjik




Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Filozofitë e kërkimit**
3. **Metodat e kërkimit**
4. **Përmbledhje**

1. Hyrje

Struktura “qepë” e kërkimit





2. Të kuptojmë filozofinë e kërkimit

- “Filozofia e Kërkimit” është një term kryesor që ka të bëjë me zhvillimin e njohurive dhe natyrën e tyre.

Adoptuar nga Saunders *et al*, (2009)

- Filozofia e kërkimit që ju zgjidhni tregon lidhje të rëndësishme me mënyrën se si ju e shihni botën.
- Këto lidhje do të ndikojnë në zgjedhjen e strategjisë suaj të kërkimit dhe metodës (përqasjes) si pjesë e strategjisë.
- Filozofia do të ndikohet
 - Pjesërisht nga praktika
 - Kryesisht nga këndvështrimi juaj për lidhjen e njohurive me procesin sipas të cilit ato prodhohen



Filozofitë e kërkimit

**Do të ekzaminojmë tre mënyrat kryesore të të menduarit
rreth filozofisë së kërkimit**

- Epistemologjia
- Ontologjia
- Aksiologjia

Epistemologjia

“Teoria e njohurive” – merret me atë çfarë përbën njohuri të pranueshme në një fushë studimi

- **Qëndrimet ndaj zhvillimit të njohurive**
 - Pozitivizmi
 - Realizmi
 - Interpretivizmi
- **Pyetja epistemologjike kryesore që ngrihet është: “*A mund të jetë e njëjtë metoda e studimit të botës sociale me atë të shkencave të natyrës?*”**
- **Përgjigja e kësaj do të tregonte mënyrën për zhvillimin e njohurive të pranueshme nga procesi i kërkimit.**



Pozitivizmi

- **Pozitivizmi – qëndrimi filozofik i shkencëtarëve të natyrës**
- **Komponentët e qasjes pozitiviste:**
 - Mendojnë që vetëm fenomenet që observojnë ata do të prodhojnë të dhëna të besueshme
 - Përdorin teoritë ekzistuese për të ngritur hipotezat që i testojnë me të dhënat e mbledhura
 - Kërkuesi e konsideron veten jashtë procesit të mbledhjes së të dhënave
 - Përdorin metodologji shumë të strukturuar, observime sasiore dhe analiza statistikore



Realizmi

- **Realizmi – qëndrimi filozofik epistemologjik që lidhet me kërkimin shkencor**
 - Mendojnë që ajo çfarë na tregojnë shqisat është e vërteta, që objektet ekzistojnë pavarësisht mendjes njerzore
 - E kundërta e **idealizmit**, teoria që thekson se vetëm mendja dhe përmbajtja e saj ekzistojnë
- **Realizmi direkt**
 - Ajo çfarë perceptojmë është realiteti. Bota është e pandryshueshme.
- **Realizmi kritik**
 - Ajo çfarë ne shohim është imazhi i botës dhe jo vetë gjërat direkt. Ajo që provojmë janë thjesht ndjesitë tona.
- **Diferenca e tyre në lidhje me kërkimin dhe prodhimin e njohurive është tek kapaciteti që ka kërkimi për të ndryshuar botën.**



Interpretivizmi

- Interpretivizmi – qëndrimi filozofik epistemologjik që mbështet faktin që kërkuesi të kuptojë ndryshimin midis njerëzve në rolin e tyre si aktorë socialë
- Për interpretivizmin është thelbësore që:
 - Kërkuesi duhet të adoptojë një qëndrim të ndjeshëm.
 - Duhet të hyjë në botën e subjektit për të cilin bën kërkimin dhe ta kuptojë botën e tyre nga ai këndvështrim.



Ontologjia

Ontologjia – studimi filozofik i natyrës së qënieve, ekzistencës dhe kategorive të tyre.

- Përqëndrohet tek natyra e realitetit, e fenomeneve sociale si etitete.
- Pyetjet ngrihen në bazë të supozimeve që kanë kërkuesit për mënyrën se si funksionon bota.

Aspektet kryesore

- **Objektivizmi**

- Entitetet sociale ekzistojnë pavarësisht aktorëve socialë duke konsideruar ekzistencën e tyre

- **Subjektivizmi**

- Fenomenet sociale krijohen nga perceptimi dhe veprimet e aktorëve socialë si rrjedhim i ekzistencës së tyre



Pragmatizmi

Pragmatizmi – traditë filozofike e cila argumenton se përcaktuesi më i rëndësishëm i filozofisë suaj të kërkimit do të jenë pyetjet e kërkimit që ju do të ngrini

- **Tashakkori & Teddlie (1988) sugjerojnë se “*ju duhet të studioni atë që ju ngjall interes dhe ka vlerë për ju, në atë mënyrë që është më e përshtatshme për ju, dhe përdorini rezultatet në atë mënyrë që ju sjellin rrjedhoja pozitive në sistemin tuaj të vlerave.*”**




Aksiologjia

Aksiologjia – degë e filozofisë që studion gjykimin mbi vlerat

- Theksohet roli që luajnë vlerat e vetë kërkuesit në të gjitha fazat e procesit të kërkimit, në mënyrë që rezultatet të jenë të besueshme

Paradigmat e kërkimit

- Një mënyrë për të ekzaminuar fenomenet sociale nga e cila mund të fitohen njohuri të veçanta mbi këto fenomene dhe të shpjegohen ato
- Qëllimi i tyre:
 - Të ndihmojnë kërkuesit të qartësojnë pikpamjen e tyre për natyrën e shkencës dhe shoqërisë
 - Të ofrojnë një mënyrë për të kuptuar përjasjen e kërkuesve të tjerë
 - Të ndihmojnë kërkuesit të kuptojnë se deri ku mund të shkojnë dhe ku jo



Cila është filozofia më e “mirë”?

- Si gjithmonë përgjigjja se cila filozofi është më e mirë varet nga pyetjet e kërkimit
- Realiteti tregon se kërkimi rrallë zë vend ekzaktësisht në vetëm një domein filozofik
- Pyetja është se çfarë rëndësie ka në praktikë të kuptuarit e pozicionit filozofik?
- Vlera praktike qëndron tek të kuptuarit e supozimeve që merren të mirëqëna. Vetëm duke i njohur ato ne mund ti analizojmë dhe ti sfidojmë nëse ka justifikim për ta bërë këtë.



3. Metodatat e kërkimit

- **Metoda deduktive** – ju identifikoni një teori dhe ngrini hipoteza, më pas dizajnoni një strategji kërkimi për të testuar hipotezat
- **Metoda induktive** – mbledhni të dhënat dhe zhvilloni teori si rezultat i analizës që i bëni të dhënave të mbledhura
- Në lidhje me filozofitë e ndryshme të kërkimit deduksioni i detyrohet më shumë pozitivizmit dhe induksioni interpretivizmit

Deduksioni – testimi i teorisë

- **Përfshin zhvillimin e një teorie e cila është subjekt i një testimi rigoroz**
- **Është metoda dominante në shkencat e natyrës**
 - Ku ligji është baza e shpjegimeve
 - Lejon parashikimin e fenomeneve
 - Predikimin e ndodhjes së tyre
 - Në këtë mënyrë lejojnë kontrollin
- **Pesë fazat sekuenciale në të cilat progreson kërkimi deduktiv:**
 - Ngritjen e hipotezave
 - Shprehja e hipotezave në terma operacionalë
 - Testimi i hipotezave
 - Ekzaminimi i rezultateve të kërkimit
 - Modifikimi i teorisë nëse nevojitet



Deduksioni – Karakteristikat

- **Shpjegon relacionet shkakësore midis variablave**
- **Vendos kontroll për testimin e hipotezave**
- **I pavaru nga kërkuesi**
- **Koncepte të operacionalizuara për matjet sasiore**
- **Përgjithësimi**



Induksioni – ndërtimi i teorisë

- **Me anë të metodës induktive mbledhjen të dhënave dhe zhvillohen teoritë si rezultat i analizës së të dhënave**
- **Ndërtimi i teorisë bëhet duke:**
 - Kuptuar mënyrën se si njerëzit ndërtojnë botën
 - Lejuar shpjegime alternative për atë që po ndodh
 - Qënë i përqëndruar tek konteksti i ngjarjeve
 - Përdorur më shumë të dhëna cilësore
 - Përdorur një sërë metodash të mbledhjes së të dhënave
- **Zgjedhja e drejtë për metodën ju ndihmon ju të:**
 - Jeni më i informuar në marrjen e vendimit për dizajnimin e kërkimit
 - Të mendoni se cila strategji do të bëjë për temën tuaj
 - Të adoptoni dizajnin për të plotësuar kufizimet

Ndryshimet midis dy metodave

Metoda Deduktive	Metoda Induktive
• Parimet shkencore • Kalimi nga teoria tek të dhënat • Nevoja për të shpjeguar relacionet shkakësore midis variablave • Mbledhja e të dhënave sasiore • Aplikimi i kontrolleve për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave • Operacionalizimin e koncepteve për të qartësuar përkufizimet • Metodë shumë e strukturuar • Pavarësi e kërkuesit nga kërkimi • Nevoja për të zgjedhur kampion me një madhësi të mjaftueshme në mënyrë që të përgjithësohen konkluzionet	• Të kuptuarin e mënyrës sesi njerzit lidhen me ngjarjet • Të kuptuarin e kontekstit të kërkimit • Mbledhja e të dhënave cilësore • Strukturë më fleksibile për të lejuar ndryshimet në thelb të kërkimit • Perceptimi që kërkuesi është pjesë e procesit të kërkimit • Përqëndrohet më pak tek nevoja për të përgjithësuar



Kombinimi i metodave

Në lidhje me pyetjen se cilën metodë të përdorim Creswell sugjeron një sërë kriteresh praktike:

- Natyra e tematikës së kërkimit
- Koha që keni në dispozicion
- Gatishmëria juaj për të marrë përsipër riskun
- Audienca ose komisioni i vlerësimit



4. Përmbledhje

- **Filozofia e kërkimit ka të bëjë me zhvillimin e njohurive dhe natyrën e tyre**
- **Filozofia e kërkuesit ka të bëjë me mënyrën se si ai e sheh botën**
 - Epistemologjia
 - Ontologjia
 - Aksiologjia
- **Epistemologjia – çfarë konsiderohet njohuri e pranueshme në një fushë studimi**
 - **Pozitivizmi** – shkencëtarët e natyrës, ligjësitë dhe përgjithësimet
 - **Realizmi** – ekzistenca e objekteve pavarësisht mendjes njerëzore
 - **Interpretivizmi** – njerzit me ndryshimet e tyre ndikojnë në rolin e tyre si aktorë socialë
- **Ontologjia – natyra e fenomeneve sociale si entitete**
 - **Objektivizmi** – entitetet sociale ekzistojnë jashtë aktorëve socialë
 - **Subjektivizmi** - fenomenet sociale krijohen nga perceptimi dhe rrjedhojat e veprimeve të aktorëve socialë



Përmbledhje

- **Pragmatizmi – përcaktuesi kryesor i filozofisë së kërkimit janë pyetjet e kërkimit shkencor**
- **Aksiologjia - studion gjykimin mbi vlerat**
 - Theksohet roli që luajnë vlerat e vetë kërkuesit në të gjitha fazat e procesit të kërkimit, në mënyrë që rezultatet të jenë të besueshme
- **Modelet e kërkimit të shkencave sociale:**
 - Funksionalist
 - Interpretivist
 - Humanist radikal
 - Strukturalist radikal
- **Ka dy mënyra kryesore të kërkimit**
 - **Deduktive** – zhvillohen teori dhe hipoteza të cilat testohen sipas një strategjie kërkimi të zgjedhur
 - **Induktive** – mbledhen të dhënat dhe analizohen dhe si rezultat zhvillohen teori të reja